



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI**

URDHËR

NR.65, datë 30.07.2021

PËR

**CAKTIMIN E KOORDINATORIT SHTETËROR
PËR MARRËVESHJET SHTETËRORE NË FUSHËN E SIGURIMEVE
PËR SHTETASIT SHQIPTARË JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikes 3 të nenit 102 të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.585, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe të planit të veprimit 2021-2025”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën

URDHËROJ:

1. Caktimin e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, znj. Megi Fino, si koordinator shtetëror për ndjekjen e procesit të iniciimit, negociimit dhe finalizimit të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit, në zbatim të masës 21, të planit të veprimit, të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, miratuar me vendimin nr. 585, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave.
2. Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme autorizohet të zhvillojë bisedimet për iniciimin dhe negociimin e marrëveshjeve shtetërore deri në nënshkrimin e tyre.



3. Për këtë proces koordinatori të raportoje, me shkrim, çdo tre muaj në mbledhjen e rradhës së Komitetit Shtetëror të Diasporës.
4. Urdhri nr. 43, datë 12.02.2019, i Kryeministrit, “Për caktimin e koordinatorit shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit”, i ndryshuar, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
EDI RAMA